# UNIVERSITETI"UKSHIN HOTI"

UNIVERSITY"UKSHIN HOTI"

**Këshilli Drejtues**

Universiteti i Prizrenit
University of Prizren
Univerzitet Prizrena
"UKSHIN HOTI"

Pranuar me dt. 16.04.2019

| Zyra e pranimit | Nr. i protokolit |
|---|---|
| 308 | 02-121 |

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com


**Nr. i ref.** **Prizren, më: ___/___/_______**

Mbështetur në Konkursin nr. 01-51 të datës 20.02.2019 në lidhje me ndarjen e bursave për vitin akademik 2016/17 dhe 2017/18 si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 01-42 komisioni për shqyrtimin e dokumentacioneve të kandidatëve që aplikuan për përfitim të bursës universitare, në përbërje: Artan Nimani - kryetar, Burim Berisha - anëtar, Nexhmedin Krasniqi - anëtar, Skender Kokollari - anëtar, Milot Krasniqi - anëtar (përfaqësues i Parlamentit të Sudentëve) dhe Arianit Berisha- anëtar (përfaqësues i Parlamentit të Studentëve), vlerësoi dhe mori:
:

## VENDIM

- Për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2016/17 dhe 2017/18.
- Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë listat preliminare me kandidatët përfitues të bursës universitare.
- Pjesë e listës sipas këtij vendimi janë të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për bursë universitare, mirëpo, përfitues janë vetëm kandidatët e hijëzuar me ngjyrë të gjelbët, ndërsa hijëzimi me ngjyrë të kuqe nënkupton refuzim (duke shënuar edhe arsyen e refuzimit).
- Lartësia e bursës universitare do të caktohet me vendim të veçantë nga Këshilli Drejtues në përputhje me mundësitë buxhetore që ka Universiteti për këtë kategori.
- Procedimi i pagesave të bursave do të bëhet pas plotëfuqishmërisë së këtij vendimi (kalimi i afatit të ankesave dhe shqyrtimi i tyre nga komisioni përkatës), dhe vendimit të Këshillit Drejtues lidhur me lartësinë e bursës.
- Pas shqyrtimit të ankesave eventuale dhe shpalljes së listës përfundimtare vendimi merr formën e prerë siç theksohet në pikën 5 të këtij vendimi.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

**Prof. Ass. Dr. Artan Nimani**
***Kryetar i Komisionit***

**Udhëzim Juridik:**
Kandidatët e pakënaqur nga ky vendim mund të ushtrojnë të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga data e publikimit të këtij vendimi në faqen zyratre të UUHP-së. Ankesat eventuale i drejtohen Komisionit të Ankesave duke e dorëzur në formë fizike në zyrën e protokollit nr. 308 në Rektoratin e Universitetit.